



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 26/15

Prishtinë, më 14.07.2015, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti, Fikrim Damka dhe Raif Qela (Antar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti dhe Industri).

Munguan: Safete Hadergjonaj dhe Bardhyl Meta.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Agim Krasniqi – Zv. Ministër i Financave, Hasan Isufaj nga Ministria e Financave, Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit të Kosovës.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Ismaili nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Faljen e Borxheve Publike.**

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015**

Kryetari – siç ju kam informuar sot do të shqyrtohen dhe votohen amendamentet të propozuara nga grupi punues lidhur me rishikimin e buxhetit, si dhe do të bëhet amendamenti i Projektligjit për Faljen e Borxheve Publike. Gjatë takimit të Grupit Punues janë vërejt se kërkesat e Institucioneve Qendrore dhe atyre Komunale kanë qenë shumë të mëdha, ndërsa mundësia për ti realizuar është shumë e vogël megjithatë, për shkak të korrektësisë janë trajtuar. Me qenë se rishikimi i buxhetit ka të bëjë më tepër me ri-sistemimin e mjeteve të parapara nuk është rrezikuar asnjë investim kapital. E kemi parasysh se gjatë procesit të rishikimit nuk lejohen projektet e reja mirëpo, është bërë një përjashtim dhe kemi ndërhy vetëm për arsye të ndjeshmërisë së projektit në Stantërg në Mitrovicë.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri miratoi Amendamentin 1.

Më pas u diskutua për tekstin e nenit 5, versioni në gjuhën serbe, respektivisht për fjalën kontigenciju, dhe në bazë të propozimeve Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri miratoi Amendamentin 2, që në nenin 5, në rreshtin e parë, në versionin serbisht, fjala “kontigenciju” të zëvendësohet me fjalët “namenjena sredstva”.

Kryetari – në Amendamentin 3, në pikën 1.1 është, shtuar shuma €70,000 në kategorinë për subvencione dhe transfere në mënyrë që Kuvendi të participojë për realizimin e himnit të Nënës Terezë.

Besa Gaxherri – nga praktika Kuvendi ose Kryetari i Kuvendit asnjëherë nuk ka dërguar amendament në Komision për Buxhet dhe Financa, si dhe nuk ka pasur ndonjëherë kërkesa për programe tjera përveç atyre që lidhen në mënyrë direkte me menaxhimin e buxhetit të Kuvendit. Andaj, insistoj që shuma e propozuar në vlerë prej €70,000 për projektin shumë të nderuar për himnin e Nënës Terezë të destinohet për kërkesa të caktuara të Kuvendit si për shembull për rregullimin apo blerjen e teknikës në hyrje Kuvendi nuk ka nevojë të ndaj mjete për këtë projekt të rëndësishëm sepse është Ministria e Kulturës dhe Zyra e Kryeministrit që duhet ti ndaj këto mjete.

Kryetari – teorikisht e ke këtë drejtë mirëpo është një ngjarje shumë e rëndësishme si politike ashtu edhe kulturore. Jam dakord që është dashtë një institucion me krye këtë obligim si Kryeministri ose Ministri i Kulturës. Nëse e tërheqim shumën prej €70,000, përsëri shumë institucione participojnë dhe nuk e rregullojmë këtë çështje prandaj, le të participon edhe Kuvendi dhe të rumbullakësohet investimi.

Latif Gashi – Shoqata Nënë Tereza në Kosovë është drejtuar te Kryetari i Kuvendit gjatë një takimi dhe ka kërkuar mbështetje financiare për projektin i cili i nderon të gjithë shqiptarët. Duke marr parasysh rëndësinë e këtij projekti, Kryetari i Kuvendit kërkon mirëkuptim që të aprovohet kërkesa për këtë shumë prej €70,000.

Besa Gaxherri – jam për ti ruajtur praktikën e mira të Kuvendit. Nëse aprovohen kërkesat e ndryshme të qytetarëve të këtij vendi, atëherë buxheti i Kuvendit duhet me qenë tjetër fare. Kuvendi nuk ka kompetencë për të dhënë mbështetje financiare për projekte të ndryshme sepse e kemi Qeverinë për këto çështje. Unë nuk jam kundër këtij projekti unë do ta mbështes shumë sipas mundësisë dhe në formë tjera.

Ismet Krasniqi – kërkesa e parë është që Kuvendi të mos këtë shkurtime. Administrata ka marr një detyrë për të njohur më mirë se cilat janë mundësitë prej të cilave mund të parasheh shkurtime nga diferenca prej €870,000 që janë më shkurt në rishikim në mënyrë që të arrihet një shumë me mirëkuptim. Nga kërkesa prej €870,000 plus €70,000 të subvencionit për himnin e Nënës Terezë në total del shuma prej €940,000 kemi ardhur te një përgjysmim në €392,000.

Latif Gashi – buxheti i Kuvendit ka shkurtime dhe e kemi një kërkesë nga Kuvendi që e ka aprovuar Kryesia dhe Grupet Parlamentare dhe është dërguar në emër tyre nga Kryetari i Kuvendit. Kryetari i Kuvendit nuk e ka bërë këtë kërkesë, por e ka bërë Administrata se këtë buxhet e menaxhon. Administrata raporton në Komision nevojat në lidhje me Deputetët, Stafin Mbështetës, dhe Administrata nuk duhet të thirret në emër të Kryetarit.

Kryetari konstaton se Komisioni me shtat vota Për, asnjë Abstenim dhe dy Kundër, miraton pikën e parë të Amendamentit 3, ndërsa njëzëri miratoi pikën 1.2 dhe 1.3., të Amendamentit 3.

Kryetari – Amendamenti 4, te Ministria e Infrastrukturës, në nënprogramin Ndërtimet e Reja të Rrugëve, projekti “Ndërtimi i rrugës Pollatë-Reçicë-Demahmetaj”, shuma prej €810,669 ndryshohet në shumën €630,669. Përse është zvogëluar kjo shumë?

Agim Krasniqi – ky ndryshim te Ministria e Infrastrukturës është bërë për shkak të obligimeve që kanë mbet nga projektet e përfshira dhe është mirë që të kryhen. Tre projekte me kontrata janë të vitit 2014 dhe nuk janë projekte të reja.

Kryetari – me këtë shkurtim a rrezikohet projekti deri në fund të vitit?

Agim Krasniqi – ndryshimi nuk e rrezikon projektin.

Latif Gashi – nuk jam për të shkurtuar mjete nga projekti, mirëpo jam për marrëveshje dhe e kuptoj që këto projekte kanë obligime, por për këtë praktik është dashtë të diskutohet në grup punues.

Avdullah Hoti – janë dy mundësi ose të behet ky amendament dhe të paguhen në mënyrë të rregullt ose me përmbarues privat me i pague interesat edhe ndëshkimet. Këto nuk janë projekte të reja, por janë projekte të vitit kaluar. Projekti Ndërtimi i Rrugës Pollatë-Reçicë-Demahmetaj në shumë €810,000 është zbrit në €630,000 sepse Ministri i Infrastrukturës konsideron se për këtë vit nuk mund të kryhen më shumë punë për të bërë pagesë dhe shuma €630,000 mjafton për këtë vit dhe këtu nuk ka asnjë problem.

Latif Gashi – tani e kuptuam që këto nuk janë projekte të reja dhe fjala “ndërtimet të reja” duhet shpjegohet që këto nuk janë projekte të reja por janë ndërtime të reja nëpër rrugë.

Kryetari – në tre projektet ku janë fjalët “shtohet projekti”, ndryshohet me fjalët “plotësohet projekti”.

Kryetari konstatoj se Komisioni njëzëri miratoi Amendamentin 4.

Raif Qela – në seancën plenare të fundit e ngrita çështjen rreth shkurtimit drastik të mjeteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit. Të gjitha institucionet pa dallim mund të afektohen si në efikasitet të punës, po ashtu edhe në sigurinë e të dhënave, si dhe në mungesë të investimeve ka mundësi që të bllokohet krejt sistemi. Shkresën që po e dorëzoj është nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit e cila është krijuar në bazë të Ligjit për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit. Shkresa njofton për detyrat të cilat nuk mund të përfundohen nëse ky buxhet shkurtohet në këtë mënyrë.

Fikrim Damka – propozojë që të shqyrtohet amendamentin 10, pasi që ka një takim me Komisionin për Bujqësi.

Kryetari – Amendamenti 10 nga Grupi Parlamentar 6+ është pa përkrahje të Grupit Punues për arsye se kriteret e shpërndarjes së mjeteve duhet ti caktoj Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Zyra e Kryeministrit duke u bazuar në një formulë e jo ne.

Fikrim Damka – kur është aprovuar buxheti 2015 e kam ngritë këtë çështje dhe më është thënë se ndoshta në rishikim të buxhetit do të shikohen mundësit. Ndarja është lineare sipas regjistrimit të popullsisë për secilin Komunitet. E kemi bërë këtë amendament tek Ministria e Komuniteteve por edhe një kërkesë tek Zyra e Kryeministrit. Besoj që duhet të ndahet ky buxhet ose Ministri duhet të inicioj që në vitin 2016 të ndahet kodë i veçantë për secilin komunitet.

Avdullah Hoti – pajtohem plotësisht dhe e përkrahu këtë por është vetëm çështje teknike se si të realizohet. Një shembull prej Ministrisë së Infrastrukturës ose Ministrisë së Arsimit kur ndërtohen

shkollat dhe rrugët nëpër Komuna nuk mund të ndahen mjetet me një formulë në përqindje të asaj apo secilës komunë sepse duhet të shqyrtohen nevojat në fillim të vitit. Ministri i Infrastrukturës apo Ministria e Arsimit, e bënë një program për rrugët në krejt komunat dhe e aprovojmë. Duhet të bëhet një program dhe të aprovohet prej Ministrisë së Kthimit edhe prej Zyrës së Kryeministrit ku adresohen nevojat e Komuniteteve në përputhje me nevojat.

Kryetari – duhet të këtë një kriter të ndarjes së mjeteve që i dedikohen komuniteteve. Ne mund ti dërgojmë letër rekomanduese nëpërmjet Kryesisë ose si Komision Kryeministrit dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim që të rregullohet kjo çështje. Nëse këta nuk e rregullojnë këtë çështje atëherë ne marrim masa tjera.

Kryetari konstaton se Komisioni me një votë Për, tetë vota Kundër dhe asnjë Abstenim nuk përkrahu Amendamentin 10, të propozuar nga Grupi Parlamentar 6+. Po ashtu Komisioni më 8 vota Për, asnjë Abstenim dhe një votë Kundër, miratohet rekomandimi që do të adresohet me shkrim Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, që për mjetet që janë paraparë në Zyrën për Komunitete në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si subvencione dhe transfero, dhe mjetet në investimet kapitale për komunitete në buxhetin e Ministrisë për Komunitet dhe Kthim, të bëhen një formulë për shpërndarjen e tyre për secilin komunitet, në shumën e caktuar, duke pasur parasysh nevojat dhe numrin e popullsisë të këtyre komuniteteve, dhe në bazë të kësaj të bëhen edhe ndarje në buxhetin e vitit 2016.

Enver Hoti – pajtohem plotësisht me vendimin që është marrë si grup punues. Sa i përket menaxhimit të mjeteve për komunitete është mirë që të kërkohet edhe një raport i cili njofton për shpërndarjen e mjeteve.

Kryetari – Amendamenti 5 të Ministrisë së Infrastrukturës Projekti “Bashkëfinancimi për K.K të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit”, shuma prej €3,651,000 ndryshohet në shumën €550,000. Mjetet e tyre kanë qenë vetëm si shumë e jo të ndara sipas projekteve, ndërsa tani shuma ndahet në projekte.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri miratohet Amendamentin 5.

Kryetari – Amendamenti 6 është shtuar Projekti “Ndërtimi i objektit për banim social për 15 familjet e Lagjes Trepça të Stantërgut - Mitrovicë”, në shumë prej €50,000. Propozoj që kjo shumë prej 50,000 të paktën të ndryshohet në €100,000.

Agim Krasniqi – mjete prej 50,000 euro, të merren nga shpenzimet e paparashikuara, dhe shuma €3,054,133 ndryshohet në shumën €3,004,133.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri e miratohet Amendamenti 6 me ndryshime në pikën tre, ku shuma 50,000€, bëhet 100,000€.

Kryetari – Amendamenti 7 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nënprogrami Administrata Qendrore, Projekti me shumën prej €6,000,000, ndryshohet në shumën €5,500,000. Më tutje, të Ministrisë së Punëve të Jashtme për Shërbimet e Konsulencës, në kategorinë mallra dhe shërbime, shuma prej €500,000, ndryshohet në shumën €1,000,000.

Agim Krasniqi – ky amendament është bërë në Qeveri dhe është bërë për arsye se Ministria e Punëve të Jashtme ka marrëveshje me Shërbimin e Konsulencës për lobim.

Kryetari konstaton se me katër vota Për, asnjë Abstenim dhe katër vota Kundër, nuk miratohet amendamenti 7.

Kryetari - propozojë që të rivotohet amendamenti 7.

Latif Gashi – në takimin që zhvillova në Grupin Parlamentar me Zëvendës-Kryeministrin dhe Ministrin i Punëve të Jashtme, ka njoftuar se shuma prej €500,000 duhet të bëhet €1,000,000 në bazë obligimeve që i ka shteti i Kosovës dhe ky është vendim i Kabinetit Qeveritar.

Kryetari – konstaton se me pesë vota Për, një Abstenim dhe tri vota Kundër, Komisioni rivotojë dhe miratohet Amendamenti 7.

Kryetari – Amendamenti 8 të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor në Projektin Bashkëfinancimi për K.K të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit shuma prej €1,898,000 ndryshohet në shumën €1,148,000.

Agim Krasniqi – janë 6 Ministri që e kanë atë fondin €15 milionë dhe çdo moment që i bëjnë projektet individuale ato kalojnë pa shkuar në procedura të Kuvendit sepse ashtu është në ligj.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri e miratoi Amendamenti 8.

Kryetari – Amendamenti 9 të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, në Projektin “Kompleksi memorial Adem Jashari” Prekaz- Skenderaj, shuma prej €1,847,093 ndryshohet në shumën €637,093. Kjo nënkupton një zvogëlim në mënyrë që të këtë rritje të mjeteve në shumë prej €500,000 për vazhdimin e punimeve në Kompleksin Memorial Beteja e Koshares, sipas kërkesës së Agjencisë shuma prej €200,000, ndryshohet në shumën €700,000. Po ashtu të Projekti Memorial i Dëshmorëve të UÇK-së, në Penuhë, shuma prej €50,000, ndryshohet në shumën €310,000. Më tutje, shtohet një projekt për Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së Marinë, Skenderaj”, në shumë prej €450,000. Me kërkesën e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës janë tërhequr mjetet nga programi i Kompleksit Memorial Adem Jashari dhe janë rishpërndarë në këto tri programe.

Latif Gashi – nuk është shkurtuar buxheti i Kompleksit Memorial Adem Jashari. Kërkesa e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është që të rishpërndahet një pjesë e mjeteve së projektit të Kompleksit Memorial Adem Jashari me qenë se shuma e dedikuar për këtë projekt e cila vazhdon të jetë që disa vite shkon në suficit. Arsyeja e Agjencisë është që këto mjete për këtë vit nuk mund të përdoren për projektin e caktuar sepse ekipi i ekspertëve ndërkombëtar nuk e ka përfunduar projektin në bazë të cilit duhet zhvillohen punimet. Andaj është kërkuar që këto mjete të mos shkojnë në suficit por të rishpërndahen në këto tre projekte të njëjtës natyrë.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri miratoi Amendamenti 9.

Kryetari – Amendamenti 11 i Deputetit Nait Hasani është pa përkrahje të Grupit Punues sepse nuk i përmbush kushtet formale dhe teknike për të qenë Amendament. Një Amendament i plotë është vetëm atëherë kur thirret në kodin buxhetor, programin, dhe shumën që pritet të shtohet, si dhe në kodin, programin dhe shumën që duhet të zvogëlohet.

Latif Gashi – këto tre projekte të rëndësishme kanë filluar më herët dhe ende nuk kanë përfunduar por me që amendamenti nuk është bërë mirë juridikisht nuk është përkrahur nga grupi punues. Ministri i

Financave sapo theksoj se ka kërkuar që Ministri i Arsimit të sjell projekte me prioritet, si dhe në fund të vitit të bëhet planifikim real dhe të përfundojnë këto projekte.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nuk e përkrahu Amendamenti 11 të propozuar nga deputeti Nait Hasani.

Kryetari – Amendamenti 12 nga Deputetja Teuta Haxhiu është pa përkrahjen e Grupit Punues sepse nuk i përmbush kushtet formale dhe teknike për të qenë amendament.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nuk e përkrahu Amendamenti 12 të propozuar nga deputetja Teuta Haxhiu..

Kryetari – Amendamenti 13 nga Deputetja Duda Balje është pa përkrahjen e Grupit Punues sepse mjetet prej €62,000 janë në Ministrin e Arsimit vetëm duhet të realizohen.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nuk e përkrahu Amendamentin 13 të propozuar nga deputetja Duda Balje.

Kryetari – Amendamenti 14 nga Deputeti Faton Topalli për ndarjen e mjeteve prej €25 milionë për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për punonjësit e Fabrikës së Gypave në Ferizaj është pa përkrahje të Grupit Punues sepse nuk i përmbush kushtet formale për të qenë amendament.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nuk e përkrahu Amendamentin 14 të propozuar nga deputeti Faton Topalli.

Kryetari – Amendamenti 15 nga Deputeti Enver Hoti për ndërtimin e nënkalimit në fshatin Dragobil (Komuna Malishevës) në vlerë €63,711 është pa përkrahje të Grupit Punues.

Enver Hoti – projekt propozimet e paraqitura janë jetike sidomos projekti në fshatin Dragobil sepse ka të bëjë me jetën e nxënësve dhe kam shpresuar që projekti të këtë përkrahje në rishikim të buxhetit mirëpo kjo nuk po ndodh.

Latif Gashi – është e vërtet që tre projektet janë shumë të rëndësishme ashtu siç janë edhe projektet tjera të cilat janë kërkuar. Me qenë se projekti konsiderohet si rast emergjent për një nënkalim nëse Ministria ka mundësi për të financuar këtë kishte me qenë mirë.

Kryetari – nëse hapet mundësia për trajtimin e projekteve të reja atëherë duhet të rikthehemi nga fillimi sepse ka kërkesa edhe nga Peja, Obiliqi, dhe Klina e tjera. Nuk jemi pajtuar që në rishikim të kemi investime të reja.

Kryetari konstaton se Komisioni me një Për, tetë vota Kundër dhe asnjë Abstenim nuk përkrahu Amendamentin 15, Amendamentin 16 dhe Amendamentin 17 të propozuar nga deputeti Enver Hoti.

Kryetari konstatoi se Raporti me amendamente e miratuara për Projektligjin për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, do të procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

Rekomandim

Raporti me rekomandime për Projektligjin për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Faljen e Borxheve Publike

Kryetari – Projektligji për Faljen e Borxheve Publike përmban gjithsej 7 nene. Janë marr parasysh edhe diskutimet e leximit në parim. A ka vërejtje në titull për Faljen e Borxheve Publike?

Agim Krasniqi – Ministri ka propozuar që të definohet se çka po falet dhe propozoj që ligji të miratohet me titullin Ligji për Faljen e Borxheve që personat fizik dhe juridik që kanë për periudhën deri më 31.12.2008 ndaj ATK-së, Doganës të Kosovës, Tatimit në Pronë, dhe borxhet ndaj Ndërmarrjeve Publike.

Kryetari – qëllimi e sqaron atë që po kërkohet të jetë titull dhe konsideroj që propozimi është i pa nevojshëm.

Agim Krasniqi – a ka mundësi që të qëllimi të vazhdohet me fjalët “që kanë karakter për periudhën deri më 31.12.2008 ndaj ATK-së, Doganës të Kosovës, tatimit në pronë, dhe borxheve të Ndërmarrjeve Publike”.

Latif Gashi – në rast se përcaktohet dhe shtohet nenin 2 të fushëveprimi konsideroj që është një gabim nga se me vet faktin se ky ligj njofton se zbatohet ndaj të gjitha Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike. Nëse numërohen institucionet mund të anashkalohet ndonjë institucion me rëndësi prandaj konsideroj se ashtu siç është mjafton.

Kryetari – propozojë që në nenin 3, në përkufizimin 1.4. Ndërmarrje Publike, në rreshtin e tretë dhe të katërt, të hiqet teksti “, ku përfshihen.”

Kryetari konstatoj se Komisioni njëzëri miratoi Amendamentin 1: Neni 3, përkufizimi 1.4. Ndërmarrje Publike, në rreshtin e tretë dhe të katërt, hiqet teksti “, ku përfshihen.”

Latif Gashi - propozojë që në nenin 3 në përkufizimin 1.6. Person, në rreshtin e parafundit, fjala “përkallëzohet”, të zëvendësohet me fjalën “ndahet”.

Kryetari konstatoj se Komisioni njëzëri miratoi Amendamentin 2: Neni 3, përkufizimi 1.6. Person, në rreshtin e parafundit, fjala “përkallëzohet”, zëvendësohet me fjalën “ndahet”.

Kryetari – propozojë që nenin 6, paragrafi 2, të fshihet, kjo për arsye se çështjen e specifikuar në paragrafin 2 e rregullon Kodit Penal.

Kryetari konstatoj se Komisioni njëzëri miratoi Amendamentin 3: Neni 6, paragrafi 2 hiqet në tërësi. Në vazhdim “paragrafët 3,4 dhe 5”, bëhen “paragrafët 2, 3 dhe 4”.

Kryetari – propozojë që në nenin 6, në paragrafin 4, në rreshtin e parë dhe të dytë, referenca “paragrafit 4 të këtij neni”, të ndryshohet në referencën “nenit 4 të këtij ligji”.

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri miratoi Amendamentin 4: Neni 6, paragrafi 4, në rreshtin e parë dhe të dytë, referenca “paragrafit 4 të këtij neni”, ndryshohet në referencën “nenit 4 të këtij ligji”.

Kryetari – propozojë që në nenin 6, në paragrafin 5, teksti “sipas dispozitave të këtij Ligji”, të zëvendësohet me tekstin “sipas nenit 4 të këtij ligji”

Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri miratoi Amendamentin 5, me këtë përmbajtje: Në nenin 6, paragrafi 5, teksti “sipas dispozitave të këtij Ligji”, zëvendësohet me tekstin “sipas nenit 4 të këtij ligji”.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Raporti me rekomandime për Projektligjin për Faljen e Borxheve Publike, procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

Mbledhja përfundoi në ora 12:35

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani